



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. / Dep. / Dep.	2-D/DPK
Nr. i faq. / Broj stranica / Nr. pages	02
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot No.	01-995/16
Data / Datum / Date	04-03-2016
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.03.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-4235/15, për z. Bashkim Cimili – Këshilltar Komunal – Komuna e Mitrovicës Veriore, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4235/15, për z. Bashkim Cimili – Këshilltar Komunal – Komuna e Mitrovicës Veriore, dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat “Bashkim”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e AKK-së.

z. Cimili është njoftuar se nuk mund të ushtroj në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë në biznesin privat, krahas funksionit publik të zyrtarit të lartë dhe për ndryshimet që duhet të bëj për të shmangur konfliktin e interesit. Ai ka premtuar se do të shmang konfliktin e interesit duke caktuar një person të autorizuar për të administruar biznesin e tij.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se ka caktuar një person të autorizuar për të menaxhuar biznesin privat “Bashkim”. Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

